



Thirrje për Shprehje Interesi

Bashkia Durres në kuadër të bashkëpunimit me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës për përfundimin e procesit të Legalizimit të Banesave Informale si edhe mbështetur në Ligjin Nr. 9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, Ligjit Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i RSH” i ndryshuar, VKM Nr. 435 datë 26.06.2024 “Për një shtesë në Vendimin Nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e bashkëpunimit në Institucionet e Administratës Shtetërore”,

Fton të gjithë të interesuarit , të cilët duan të bëhen pjesë e këtij procesi të aplikojnë duke dorëzuar pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, Bashkia Durrës, dokumentacionin listuar si më poshtë:

- 1.Letër motivimi
- 2.CV e Kandidatit
- 3.Fotokopje e noterizuar e diplomës (Bachelor)
- 4.Fotokopje e kartës së identitetit (ID);
- 5.Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
- 6.Vërtetim të gjendjes shëndetësore
- 7.Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë,vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Kjo thirrje është e hapur për të gjithë të interesuarit të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë në degët e Inxhinierisë së Ndërtimit, Arkitekturë, Gjeodezi ,Urbanist, Gjeoinformacion, Topograf dhe Juridik.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet deri ***në date 26.09.2024.***